



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-6750//24
Kaçanik, 29.03.2024

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 mars 2024, pos tjerash;

NJOFTOHET

1. Me Raportin e Periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për afatin 15 mars 2024.
2. Në Raportin si në pikën 1 të kësaj shkrese, është paraqitur progresi i zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për të gjeturat në Pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2022.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është; “Raporti periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit/ Lënda 01Nr.104/02-6750/24.

Më këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursej





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	15.03.2024	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	01-104/02-6750/24			

Kacanik Kaçanikut
Komuna e Opština
Municipal Kacanik

Për	Zyrën Kombëtare të Auditimit
Kopje	Kryesuesi i Kuvendit Komunal Kaçanik
Nga	Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi
Datë	15 mars 2024



RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Në bazë të nenit 14, pika 5 e Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, në fuqi që nga qershori 2019, ku thuhet se: *Pas hartimit të planit të veprimit, entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy here në vit, respektivisht deri më 30 shtator dhe 15 mars.*

Prandaj, në përgjigje të kësaj kërkesë, Komuna e Kaçaniku ka përgatitur këtë raport lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti I Auditimit.

Mars 2024

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE, KOMUNA E KAÇANIKUT

Raportimi për afatin 15 mars 2024

Nr	Komponenta e auditimit	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit(i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1	Pagesa e avansit prej 10% të vlerës së kontratës për investime kapitale pa u paraparë në kontratë dhe me kushte të veçanta	<p>Neni 13 i Ligjit nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 parasheh se "Organizatat buxhetore mund të iu paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në 15% të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë euro (10,000 €), e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. Në muajin nëntor pagesa e paradhënies është e kufizuar deri në dhjetë përqind (10%) dhe në muajin dhjetor të vitit 2022 deri në pesë përqind (5%) të vlerës së kontratës".</p> <p>Te projekti "Ndërtimi i objektit për banim social" në vlerë 406,747, e lidhur</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të lejojë pagesë në paradhënie nëse një gjë e tillë nuk është e paraparë me kushte të veçanta të dosjes së tenderit dhe me kontratë të lidhur mes komunës dhe operatorit ekonomik.</p>	<p>Kryetari dhe Zyra e Prokurimit kanë marrë masat dhe pagesat për paradhënie do të jepen vetëm nese ato janë te pershira ne kontratën e lidhur mes komunës dhe operatorit ekonomik.</p>	I zbatuar.	Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.

		<p>më 19.10.2022, zyra e prokurimit në dosjen e tenderit të kushtet e veçanta të kontratës si dhe të kontrata e lidhur me operatorin ekonomik nuk e kishte paraparë pagesën në paradhënie. Menaxheri i projektit dhe operatorit ekonomik në muajin nëntor të vitit 2022 kishin kërkuar lejim të paradhënies prej 10% të vlerës së kontratës, me q'rast Kryetari me 15.11.2022 lejoi që pagesa të bëhet në paradhënie në vlerë 40,676, edhe pse ajo nuk ishte e paraparë. Kjo ka ndodh me arsyen e operatorit ekonomik lidhur me rritjen e çmimeve në tregun e materialit të ndërtimit.</p>				
2	<p>Tejkalim i sasive në pozicionet e kontraktuara</p>	<p>Komuna kishte hartuar paramasën dhe parallogarinë për projektin "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike". Në këtë paramasë ishin paraparë sasitë që duhet të kryhen për secilin pozicion që priten të realizohen.</p> <p>Te kontrata "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" e lidhur me datën 22.10.2021 në vlerë 92,414€, kemi vërejtur tejkalim të sasive në pozicionet e kontraktuara. Tejkalimet ishin tek pozicioni i punëve paraprake, vlera e kontraktuar ishte 900€, ndërsa e realizuar 1,453€, pozicioni punët e gërmimit vlera e kontraktuar 16,969€ e realizuar 27,368€, pozicioni punët latuese të kontraktuar 200€ të realizuara 1,036€, punët montuese të</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur ka ndryshime materiale të pozicioneve të realizuara krahas të pozicioneve kontraktuara kontratat e tilla të ndërpriten.</p>	<p>Janë ndërmarrë masat e nevojshme nga Kryetari i komunës dhe është vepruar konform ligjeve dhe rekomandimit përkatës nga Auditori i jashtëm</p>	<p>I zbatuar.</p>	<p>Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.</p>

		<p>kontraktuar 43,665€ të realizuara 45,462€. Ndërsa pozicionet të cilat nuk ishin realizuar sipas kontratës ishin: punët e kanalizimit atmosferik të kontraktuar 17,834€ të realizuar 4,409€, punët e betonit të kontraktuar 10,635€, të realizuara 8,800€. Edhe pse kishte ndryshime materiale në kontratë. Komuna nuk e kishte ndryshuar a po ndërpre kontratën. Vlen të theksohet se kontrata në total nuk është tejkaluar.</p> <p>Ndryshimi i pozicioneve të kontraktuar ka ndodhur si rezultat hartimit të paramasës dhe parallogarisë në mungesë të projektit ekzekutiv.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se mjetet monetare të grumbulluara nga taksa për regjistrimin e automjeteve dhe çertifikatave do të deponohen në fund të ditës.</p>	<p>Është vepruar konform Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat, e cila parasheh se paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të hyre përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues "UNIREF".</p>	<p>I zbatuar.</p>	<p>Të hyrat e rumbulluara nga taksa për çertifikata tjera, të cilat inkasohen nga zyrtaret e gjendjes civile ne vendbanime te largëta, dorëzojnë mjetet ne intervale me te gjata pershikak te pamundësisë dhe te njëjtat janë vonuar edhe ne deponim ne bankë.</p>
<p>3</p>	<p>Vonesa në deponimin e mjeteve në llogari bankare</p>	<p>Neni 11 paragrafi 2 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parasheh se "Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyre përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF".</p> <p>Mjetet monetare në vlerë 4,080.00e, të grumbulluara gjatë muajit janar (05-28.01.2022) nga taksa për regjistrimin e automjeteve ishin deponuar po thuajse një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit 31.01.2022), po ashtu, mjetet monetare në vlerë 839.00e, të grumbulluara nga taksa për çertifikata tjera gjatë muajit nëntor (01-25.11.2022) ishin deponuar një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit 30.11.2022).</p>				

4	<p>Mungesa e projekteve ekzekutuese</p>	<p>Kjo ka ndodh nga pakujdesia e zyrtarit përgjegjës për t'i deponuar mjetet monetare në llogarinë bankare të komunës.</p> <p>Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik respektivisht pika 20.13 ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknikë, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejonet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".</p> <p>Në dy (2) raste, kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projekte ekzekutuese. Rastet ishin tek kontratat: "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike SHFMU Nazim Osmani" në vlerë 315,916€ dhe "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale" në vlerë 275,843€.</p> <p>Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e Komunës për të hartuar projekte ekzekutuese ashtu siç kërkohet me kërkesat ligjore.</p>	<p>Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.</p>	<p>Tashmë ekziston kontrata me operatorin ekonomik, lidhur me hartimin e projekteve dhe secili projekt paraprakisht ka të hartuar projektin ne detaje.</p>	<p>I zbatuar.</p>	<p>Nuk ka pasur sfida në zbatimin e këtij rekomandimi.</p>
---	--	--	--	--	-------------------	--

